




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E  
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM  
TIRANË

Nr. 753 Akti  
Dt. 09.05.2023 Regj

Nr. 59347 Vendim  
Dt. 12.10.2023



VËNDIM  
“PËR KTHIM AKTESH”

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e përbërë prej:

**AGRON ZHUKRI – GJYQTAR**

Më cilësinë e gjyqtarit të vëtëm, sot më datë 12.10.2023, mori në shqyrtim kërkesën që i përkët:

- KËRKUES:** Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH), përfaqësuar nga Presidenti z. Fidel YLLI, dtl. 01.09.1962, i lindur në Tiranë, banues në Tiranë, mbajtës i Letërnjoftimit me nr. G20901138Q. Rr. “Liman Kaba”, Parku Olimpik, Tiranë.
- OBJEKTI:** Depozitimi dhe regjistrimi i Vendimit dt. 29.04.2023 të Asamblesë së Përgjithshme Vjetore të 28-të të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH).
- BAZA LIGJORË:** Kushtetuta e Shqipërisë; Ligji Nr. 8789, datë 07.05.2001 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, i ndryshuar; Ligjit Nr. 8788, datë 7.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, LIGJI Nr. 79/2017.

Gjykata pasi shqyrtoi kërkesën, e Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH), ku kërkon të depozitoj Vendimit dt. 29.04.2023 të Asamblesë së Përgjithshme Vjetore të 28-të të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH) dhe rregjistrimin e këtij vendimi në Regjistrin e Organizatavë Jo Fitimprurësë të Gjykatës së Rrëthit Gjyqësor Tiranë

VËRËN

Kërkuësi, Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH) ka paraqitur kërkesën për “Depozitimi dhe regjistrimi i Vendimit dt. 29.04.2023 të Asamblesë së Përgjithshme Vjetore të 28-të të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH)”.

Gjykata në shqyrtimin e akteve të depozituara për Depozitimit dt. 29.04.2023 të Asamblesë së Përgjithshme Vjetore të 28-të të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar

(KOKSH), konstaton se ndër të tjera në këtë mbledhje është vendosur zgjedhja e 1 anëtarit të KAS duke zëvendësuar anëtarin znj. Marjana Semini.

Gjykata, konstaton se me vendimin nr. 5934/6, datë 23.06.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë është vendosur: Pranimin pjesërisht të kërkesës. Depozitimim e Vendimit datë 29.10.2022 të Asamblesë së 27-të të Përgjithshme Zgjedhore të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, përta i përket pikave 1,2,3,4. Pranimin e pjesëshëm të pikës 5 të Vendimit datë 29.10.2022 të Asamblesë së 27-të të Përgjithshme Zgjedhore të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar për zgjedhjen e dy anëtarëve themelues të KAS dhe rrëzimin e kërimit për anëtarin Marjana Semini.

Për sa u parashtrua më lartë në kushtet kur anëtarja Marjana Semini nuk është regjistruar pranë regjistrimit të OJF-ve si anëtare e KAS pasi vjen në kundërshtim me ligjin nr. 8577, datë 10.02.2000 (ndryshuar me ligjin nr. 99/2016 dhe ligji nr. 45/2001), orientohet pala kërkuese që te rimbledhe dhe nje here Asamblene e Pergjithshme Vjetore te Komitetit Olimpik Shqiptar (KOKSH) duke perfshire nder te tjera ne vendimarrje dhe rizgjedhjen e një antari (Aida Gugu Bushati) të ri të KAS dhe jo të zëvendësojë atë.

Në këto rrethana, për sa parashtruar më sipër Gjykata vlerëson se dokumentacioni i paraqitur për Depozitimim e Vendimit dt. 29.04.2023 të Asamblesë së Përgjithshme Vjetore te 28-të të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH), nuk është konform ligjit dhe gjykata cmon t'i kthejë aktet konform nenit 154/a të Kodit të Procedurës Civile.

### PËR KËTO ARSYË

Gjykata në bazë të nenit 154/a të Kodit të Procedurës Civile  
**VËNDOSI**

- Kthimin e kërkesës dhe të akteve të tjera që i përkasin çështjes civile me Nr.Regj.Them 753 palës kërkuese .
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, brenda 5 (pësë) ditëve nga e nesërmyja e komunikimit të vendimit.
- U shpall në Tiranë sot më dt.12.10.2023.

Vendimi mori forme te prere pasi  
nuk u ankimua me dt 30.10.2023  
Tirane me dt 08.11.2023

K / SEKRETAR  
MIMOZA Tafa

